



MARRËDHËNIET SHQIPËRI-GREQI NË SYTË E PUBLIKUT SHQIPTAR – PERCEPTIME 2013

Alba Cela
Sashenka Lleshaj



**FRIEDRICH
EBERT** 
STIFTUNG

“Marrëdhëniet Shqipëri-Greqi në sytë e publikut shqiptar – perceptime 2013”



Tiranë, Mars 2014

Falënderime

Instituti shqiptar për Studime Ndërkombëtare dëshiron të shprehë mirënjohje për Friedrich Ebert Stiftung në Shqipëri (FES- Tirana) për mbështetjen e këtij projekti.

Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung
Office Tirana
Rr. Abdi Toptani
Torre Drin, Kati i 3-të
KutiaPostare 1418
Tiranë, ALBANIA

Autorët: Alba Cela
Sashenka Lleshaj

© Fondazioni Friedrich Ebert

Publikimet e FES-it nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

Hyrje

Në intervistën e tij të parë për gazetën e rëndësishme greke *Kathimerini*, pas zgjedhjeve të 23 qershorit, Kryeministri i ri Edi Rama tha se periudhës së dimrit Siberian në marrëdhëniet ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë po i vjen fundi dhe se ‘vera’ po afrohet pak nga pak.¹ Ai po i referohej problemeve që kanë patur të dy vendet pas dështimit për arritjen e një marrëveshjeje reciproke mbi caktimin e kufijve të shelfit kontinental dhe zonave bregdetare Greqi-Shqipëri ose siç njihet ndryshe nga media dhe opinioni publik shqiptar *çështja e kufirit detar*. Marrëveshja e përgatitur nga përfaqësues të qeverive përkatëse u konsiderua anti-kushtetuese në Shqipëri pasi vetë Partia Socialiste e çoi rastin në gjyq. Më pas, në fushatën elektorale, Kryeministri Sali Berisha i rriti tonet e tij nacionaliste duke e armiqësuar edhe më tej fqinjin jugor. Gjithë kësaj shtate ju shtuan edhe problemet e emigrantëve shqiptarë në Greqi, në lidhje me emrat e vendlindjes, një rast në të cilin pasaportat e fëmijëve të tyre e kanë vendlindjen të shkruar në shqip në vend të emrit që njihet ndërkombëtarisht për to.²

Në atë kohë kjo ishte vetëm seria e fundit e ngjarjeve në një marrëdhënie komplekse dhe emocionale ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, që i ngjan më tepër atyre të telenovelave. Këto dy fqinjë që dikur shkrimtari i njohur Ismail Kadare i ka quajtur “popujt më të vjetër në Evropë”. Historia e ka ngarkuar marrëdhënien e tyre me doza të larta drame dhe konflikti e gjithësesi me lidhje njerëzore,

1. Intervistë: Edi Rama. *Kathimerini*, 30 qershor 2013.

2. Një shembull është për një person që ka lindur në Thessaloniki në pasaportën e të cilit shënohet “Selanik”, që është version korrekt në gjuhën shqiptare por jo version i pranuar ndërkombëtarisht për këtë qytet. Shembuj të tjerë përfshijnë Athina (në shqip) në vend të Athens. Kjo aplikohet gjithashtu për emrin e vendit që njihet si “Greece” ndërkohë që në shqip është Greqi.

kulturore dhe ekonomike që i mbajnë ato të lidhur.

Në këtë marrëdhënie dashuri-urrejtje karakteristike e stilit ballkanik, shqiptarët nga ana e tyre janë mjaft pasionantë. Kur Shqipëria fitoi një ndeshje futbolli kundër Greqisë, menjëherë pasi skuadra kombëtare greke u shpall kampione e Evropës në shtator të vitit 2004, shqiptarët e festuan fitoren e tyre si shëlbim të atyre që i konsideronin vuajtjet që fqinji jugor i kishte shkaktuar. Një dekadë më vonë, shumë shqiptarë ende mendojnë se ajo ishte loja e shekullit.

Për rrjedhojë, është e domosdoshme të bëhen përpjekje për të kuptuar perceptimet dhe implikimet e tyre mbi politikën dhe diskursin politik përmes hulumtimit objektiv. Ky studim fillimisht do të përmbledhë një listë të çështjeve kryesore që kushtëzojnë marrëdhënien ndërmjet këtyre dy vendeve fqinje duke u fokusuar tek debatet bashkëkohore. Një shënim mbi objektivat e studimit është përfshirë para prezantimit të gjetjeve kryesore nga sondazhi kombëtar i kryer në Shqipëri në vitin 2013. Një studim paralel është zhvilluar nga Fondacioni Helenik për Politikën Evropiane dhe të Jashtme (ELIAMEP). Krahësimet ndërmjet perceptimeve ishin subjekt i të dy konferencave të organizuara në kontekstin e këtij projekti dhe të diskutuara në Tiranë dhe Athinë respektivisht në nëntor dhe dhjetor të vitit 2013. Një analizë krahasuese do të jetë subjekt i raportit të ardhshëm të AIIS dhe ELIAMEP.

Fjalorth i çështjeve

Shumëllojshmëria dhe kompleksiteti i çështjeve që përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, çështje këto që kanë ndikuar edhe në perceptimet e qytetarëve në dy anët e kufirit, duken si një mozaik i komplikuar ku secila pjesëz është pandashmërisht e lidhur me tjetrën. Në varësi të kohës dhe kontekstit, çështje të caktuara marrin rëndësi të veçantë në krahasim me të tjerat, deri në momentin që një incident i ri ndodh apo një raport i ri mediatik zhvendos vëmendjen publike në një element tjetër me rëndësi. Në vazhdim paraqitet një listë e përgjithshme, edhe pse jo shteruese, e faktorëve që përbëjnë axhendën aktuale të çështjeve midis Shqipërisë dhe Greqisë:

Kufiri detar

Ndërkohë që çështje që lidhen me kufijtë detar dhe kontrollin e Detit të Mesdheut kanë qenë shpesh në qendër të disa situatave konfliktuale midis shteteve,³ Shqipëria dhe Greqia janë protagonistet e njërit prej këtyre rasteve ku kufiri i sovranitetit territorial të shteteve, përfshirë të drejtën për shfrytëzim ekonomik në Detin Jon nuk janë përcaktuar në mënyrë të qartë. Pas më shumë se dy vite negociatash ndërmjet qeverive të dy vendeve, një marrëveshje u arrit në Tiranë në prill të vitit 2009 gjatë një takimi të nivelit të lartë midis Kryeministrit shqiptar Sali Berisha dhe homologut të tij grek, Costas Karamanlis. Marrëveshja Shqipëri-Greqi për ndarjen e shelfit kontinental dhe zonave detare u nënshkrua zyrtarisht nga Ministrat e Jashtëm të dy vendeve, Lulzim Basha dhe Dora Bakoyannis.⁴

3. Kliot, N. (1987). Maritime Boundaries in the Mediterranean Sea: Aspects of Cooperation and Dispute, in Blake, G. H. (ed), *Maritime Boundaries and Ocean Resources*. Pp. 208-226.

4. Hellenic Communication Service. (2009). *Greece, Albania Sign Continental Shelf Pact*. Online: <http://www.helleniccomserve.com/greecealbaniasign.html>.

Me nënshkrimin e marrëveshjes pasuan një seri deklarata në mediat kombëtare nga ekspertë shqiptarë të çështjeve ushtarake dhe të së Drejtës Ndërkombëtare të cilët pretendonin se marrëveshja kishte parregullsi dhe abuzime në përcaktimin e kufijve detar.⁵ Këto debate ushqyen edhe zërat e partive politike nacionaliste në vend të cilat tashmë kishin një repertor më të pasur materiali për të përfshirë në retorikën e tyre. Si pasojë e këtyre pakënaqësive në opinionin publik shqiptar, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë e anuloi marrëveshjen “si pasojë e ‘shkeljeve procedurale dhe substanciale’ të kushtetutës dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit (UNCLOS)”.⁶ Kjo çështje është ende pezull dhe u ripërmend së fundmi gjatë vizitës në Tiranë të Zv/Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme të Greqisë, Evangelos Venizelos. Interesat e dyanshme për eksplorime të mundshme të puseve të naftës nga firmat amerikane dhe kanadeze në ujrat e Detit Jon e bën çështjen akoma më urgjente për palët.⁷

Emigrimi

Rreth 700 mijë⁸ qytetarë shqiptarë mendohet se banojnë në Greqi edhe pse shifrat zyrtare variojnë nga një burim në tjetrin duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e këtyre emigrantëve ka qëndruar në Greqi në mënyrë të paligjshme. Greqia është vendi me më shumë

5. Likmeta, B. (2009). Experts Reject Greek-Albanian Land Grab Claim. *Balkan Insights*. Online: <http://www.balkaninsight.com/en/article/experts-reject-greek-albanian-land-grab-claim>.

6. International Boundary Research Unit (IBRU). (2010). Albanian constitutional court nullifies maritime boundary agreement with Greece. *Durham University*. Online: <https://www.dur.ac.uk/ibru/news/boundary-news/?itemno=9534&rehref=%2Fibru%2Fnews%2F&resubj=Boundary+news%20Headlines>.

7. Tirana Times, (2012). [Greece to start oil search near Albanian waters](http://www.tiranatimes.com/news.php?id=9157&cat=1). Online: <http://www.tiranatimes.com/news.php?id=9157&cat=1>.

8. Albanian Screen (2013). 32.5 % e shqiptarëve që jetojnë si emigrantë: Pjesa më e madhe në Greqi. Online: http://news.albanianscreen.tv/pages/news_detail/56180/ENG.

emigrantë shqiptarë, të cilët tashmë kanë përparuar shumë në lidhje me integrimin në shoqërinë greke. Ndërkohë që shqiptarët përbëjnë rreth 60 përqind⁹ të numrit të emigrantëve në Greqi, përvetësimi me sukses i gjuhës greke si dhe përqëndrimi tradicional i tyre në punë si bujqësia, ndërtimi, punët shtëpiake, industria ushqimore si dhe në shërbime të tjera të lidhura me turizmin¹⁰ kanë kontribuar që shqiptarët të arrijnë të bëhen një pjesë e rëndësishme e shoqërisë dhe ekonomisë greke. Rruga e tyre drejt integritit ka qenë më e vështirë krahasuar me eksperiencën e emigrantëve shqiptarë në vende të tjera. Në fillim të viteve '90, raportime të abuzimeve me emigrantët në Greqi, si rrahje nga policia dhe operacioni famëkeq i deportimit “Fshesa”,¹¹ i nxitën shqiptarët të kultivonin një ndjesi inati dhe pakënaqësie në lidhje me Greqinë. Ndërkohë që numri i emigrantëve të paligjshëm shqiptarë në Greqi ka rënë paralelisht me integrimin e tyre të suksesshëm në shoqërinë greke, ndjenjat aktuale kundër emigrantëve në Greqi duket se janë orientuar drejt komuniteteve të emigrantëve të tjerë në vend, sidomos drejt atyre që vijnë nga Afrika, Azia apo Lindja e Mesme.

Kriza financiare aktuale në Greqi ka detyruar shumë familje shqiptare të kthehen në shtëpi. Sipas një studimi të fundit në Shqipëri, ndërkohë që është e vështirë të maten hyrjet ekzakte të emigrantëve shqiptarë, “duke kombinuar disa statistika të pjesshme, është vlerësuar që në 5-vjeçarin e fundit, midis 18 dhe 22 përqind e

9. Baldwin-Edwards, M. and Kyriakou, G., (2004). Statistical Data on Immigrants in Greece: An Analytic Study of Available Data and Recommendations for Conformity with European Union Standards. Mediterranean Migration Observatory UEHR, Panteion University.

10. Baldwin-Edwards, M. (2004). Albanian Emigration and the Greek Labour Market: economic symbiosis and social ambiguity. *South East Europe Review*. Pp 3-5.

11. International Crisis Group (ICG). (2001). Albania: The State of the Nation 2001. *Balkans Report N°111*. Tirana/Brussels.

emigrantëve shqiptarë në Greqi janë kthyer në Shqipëri”.¹² Si pasojë e kësaj tendence të kohëve të fundit Shqipëria është duke u përballur me çështje të riintegritimit social të emigrantëve të rikthyer, ndërkohë që është shënuar edhe një rritje e lehtë në remitanca nga Greqia prej vitit 2009 si pasojë e tërheqjes nga bankat greke të kursimeve të emigrantëve të rikthyer.¹³ Një pjesë e madhe e të rikthyerve janë emigrantë shqiptarë tashmë në moshë pensioni si dhe ata të cilët ishin të punësuar në punë sezonale.¹⁴ Edhe pse kjo tendencë ka qënë e qëndrueshme gjatë 5-vjeçarit të fundit, komuniteti i emigrantëve shqiptarë në Greqi akoma mbetet një nga komunitetet më të mëdha në vend.

Integrimi në Bashkimin Evropian

Integrimi në BE përbën një prej prioriteteve kryesore të vendit, prioritet ky i artikuluar në retorikën publike të partive më të mëdha në Shqipëri dhe i përforcuar nga një mbështetje e gjerë popullore.¹⁵ Greqia, nga ana tjetër, ka qënë vendi ku është mbajtur një nga eventet më të rëndësishme për politikën e zgjerimit në BE, Samiti i Selanikut, ku zotimi i BE-së për të përfshirë vendet e Ballkanit Perëndimor në familjen evropiane u rikonfirmua bindshëm. Megjithatë politika e jashtme zyrtare e Greqisë ka qënë pro zgjerimit, Greqia në disa raste ka rezultuar të jetë një pengesë e pa kapërcyeshme për vende të tjera në një seri çështjesh, ku më e rëndësishmja është çështja e emrit me Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Gjithsesi, anëtarësia

12. Albanian Centre for Competitiveness and International Trade (ACIT), (2012). *Study on the Economic Impact of the Greek Crisis in Albania*. P.9. Online: <http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/USAID%20Study%20on%20Greek%20Crisis.pdf>.

13. Ibid. p ii.

14. Kasimis, C. (2012). *Greece: Illegal Immigration in the Midst of Crisis*. Online: <http://www.migrationinformation.org/Profiles/display.cfm?ID=884>.

15. AIIS ka zhvilluar sondazhe të përvitshme për të matur mbështetjen popullore për integrimin, që nuk ka rënë asnjëherë poshtë 80 përqindëshit. Shihni: [www.aiis-albania.org](http://aiis-albania.org).

e Greqisë në BE është një mundësi për aspiratat e integritit të vendeve fqinje.

Përgjatë rrugës së Shqipërisë drejt integritit në BE, Greqia ka qënë një partner i rëndësishëm edhe pse jo gjithmonë konstant në mbështetjen e tij. Në lidhje me statusin e vendit kandidat të Shqipërisë, Greqia ka shprehur mbështetjen e saj në disa raste. Kështu, pak para mbledhjes së Këshillit të Ministrave të BE-së, ku vendimi për t’i dhënë Shqipërisë statusin e vendit kandidat u shty për më vonë, Ambasadori grek në Tiranë, Leonidas Rokanas, theksoi mbështetjen e fortë të Greqisë për integrimin evropian të Shqipërisë.¹⁶ Kjo deklaratë është pasuar kohët e fundit me një tjetër, ku këtë radhë ishte Zv/Kryeministri dhe Ministri i Jashtëm grek, Evangelos Venizelos, i cili ritheksoi mbështetjen e Greqisë dhe u shpreh se “Shqipëria duhet ta marrë statusin e vendit kandidat në korrik”.¹⁷ Mbështetja e Greqisë në këtë çështje bëhet akoma më e rëndësishme dhe domethënëse në momentin që ky vend ka presidencën e radhës në Këshillin e BE-së që nga fillimi i 2014-ës.

Çështja Çame

Në vija të përgjithshme, çështja çame i referohet shpërnguljes së dhunshme të komuniteteve të shqiptarëve etnik nga Greqia veriore drejt Shqipërisë në fund të luftës së dytë botërore. Të akuzuar për bashkëpunim me nazistët, popullsia çame u detyrua të linte shtëpitë dhe vendbanimet e tyre ndërkohë që shumë u dhunuan dhe u vranë gjatë dëbimit.¹⁸ Që nga ajo kohë, ky komunitet ka kërkuar nga Greqia që të pranojë ndodhjen e këtij spastrimi etnik, të kërkojë falje për

16. Tirana Times, (2013). *Albanian-Greek relations: Beyond the status quo*. 8:47. P. 7.

17. Tirana Times. (2014). *Greece to support Albania’s EU integration process*. 9:1. P. 5.

18. Për më tepër informacione për këtë çështje shihni Vickers, M. (2002). *The Cham Issue: Albanian National & Property Claims in Greece. Conflict Studies Research Centre*. G 109.

këto krime si dhe të njohë të drejtën e pronës së shqiptarëve të shpëngulur.

Edhe pse Greqia këmbëngul që çështja çame nuk ekziston dhe për pasojë i referohet asaj si një ‘jo-çështje’,¹⁹ në Shqipëri, konsideratat politike në lidhje me këtë çështje kanë ardhur në rritje. Kauza tashmë po advokohet nga forca të ndryshme politike që përfaqësojnë këtë komunitet, ku më e madhja prej tyre është Partia për Drejtësi, Integritim dhe Unitet (PDIU). Në zgjedhjet e fundit parlamentare PDIU-ja, e njohur ndryshe si Partia e Çamëve, fitoi pesë vende në Kuvend, një prezencë kjo domethënëse. PDIU-ja, gjatë katër viteve të fundit, ka folur për përpilimin dhe ratifikimin në Kuvend të një Rezolute Çame e cila do të adresojë çështjen çame si dhe kërkesat e popullatës çame.²⁰ Qëndrimi i Greqisë në lidhje me këtë çështje ka krijuar pakënaqësi në një rreth më të gjerë sesa vetëm popullsia çame. Përpjekjet e policisë greke për të penguar filmimet dhe raportimet nga media shqiptare të disa fshatrave në veri-perëndim të Greqisë ku akoma mbizotërojnë komunitetet shqipfolëse kanë shkaktuar mjaft pakënaqësi dhe debat në Shqipëri.²¹

Kisha Ortodokse

Regjimi komunist ndaloi çdo formë manifestimi me karakter fetar në Shqipëri duke shënuar kështu një precedent historik të një politike

19. Ibid.

20. Panorama [online]. (2012). *Zbardhet rezoluta çame: te kthehen pronat 10 miliard euro*. Online: <http://www.panorama.com.al/2012/12/10/rezoluta-came-sot-ne-kuvend/>.

21. Një prej gazetarëve që bëri një emission për fshatrat greke ku flitet shqip, Marin Mema (figure publike dhe e mirënjohur në Shqipëri), nuk u lejua të hynte më në Greqi dhe u deklarua persona non grata. <http://www.shqiptarja.com/media/2710/gazetari-i-top-channel-marin-mema-shpallet-non-grata-ne-greqi-112930.html>, 19/09/2012. Në një tjetër dokumentar të Top-Channel mbi Çamërinë, pamjet shfaqnin police grek që ngacmonin gazetarët dhe i kërkonin atyre të mos filmonin më ndërkohë që i shoqëronin në makinën e policisë.

ateiste. Gjithsesi, shumica e besimtarëve në Shqipëri vazhduan të praktikonin ritet fetare në fshehtësi. Me ndryshimin e sistemit, feja u riafirmua si një e drejtë bazike e njeriut. Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, një prej tri feve zyrtare në vend, që prej fillimit të viteve '90 është drejtuar nga një grek: Kryepeshkopi Anastasios Janullatos.²² Një prej argumenteve që mbështeti fillimisht zgjedhjen e një jo-shqiptari në krye të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë ishte mungesa e figurave shqiptare me eksperiencën dhe dijen e nevojshme për të mbajtur këtë post. Ky argument ka humbur peshë me kalimin e kohës në favor të mendimeve se ka ardhur koha që Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë të drejtohet nga një prift shqiptar.²³

Feja dhe politika u përballën edhe njëherë në vitin 2013 me incidentin e kishës së Përmetit (qytet në jug të Shqipërisë), ku ndërtesa u konfiskua nga forcat policore pas një vendimi të gjykatës i cili e cilësonte objektin si pronë publike.²⁴ Ky veprim u prit me një notë proteste nga Ministria e Punëve të Jashtme e Greqisë²⁵, shqetësim ky që shkaktoi habi në Shqipëri dhe u shndërrua në argument në favor të atyre që deklarorin se Greqia ushtron influencë jo legjitime brenda Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.

22. Kryepeshkopi Anastasios Janullatos u zgjodh kreu i Kishës Ortodokse Shqiptare në vitin 1992. Ky pozicion u parapri nga Patriarchal Exarch në Shqipëri që u mbajt prej tij nga janari i vitit 1991 deri në qershor 1992.

23. Një debat mjaft i pranishëm në shqipëri që del në sipërfaqe here pas here në gazeta, shih për shembull: “At Nikolla Marku: Her are my conflicts with Janullatos-an open letter to American Ambassador Arvizu” <http://www.gazetametropol.com/at-nikolla-marku-ja-konfliktet-e-mia-me-janullatosin/>

24. Top Channel (2013). *Police takes building in Permet*, Online: <http://www.top-channel.tv/english/artikull.php?id=9793>.

25. Korologou, M. (2013). *Albanians Pull Down Bell Tower in Permet*. Online: <http://eu.greekreporter.com/2013/08/17/albanians-pull-down-bell-tower-in-permet/>.

Minoriteti grek dhe partitë minoritare

Krahasuar me grupet e tjera minoritare, minoriteti grek është më i madhi në Shqipëri dhe gjendet në pjesën jugore të vendit. Duke qënë se ka shifra të ndryshme në lidhje me numrin e pjesëtarëve të këtij komuniteti, është i vështirë raportimi i një numri të gjithëpranuar. Kështu, në fillim të viteve 2000, qeveria shqiptare raportoi një shifër prej 60 deri në 70 mijë anëtarësh të këtij minoriteti, ndërkohë që qeveria greke raportonte 200 deri në 400 mijë persona.²⁶ Minoriteti grek në Shqipëri dhe sidomos të drejtat politike dhe sociale të tij kanë qënë një komponent themelor i marrëdhënieve Shqipëri-Greqi duke u vendosur jo rrallë në qendër të mosmarrëveshjeve. Ndërkohë që disa studime theksojnë marrëdhëniet relativisht të mira midis pakicës greke dhe shumicës shqiptare në jug të Shqipërisë, këto studime gjithashtu theksojnë instrumentalizimin negativ të etnisë për përfitime politike nga të dyja anët, apo presionin e jashtëm që ushtrohet ndaj popullsisë në periudha të ndryshme, sidomos gjatë periudhave zgjedhore.²⁷

Që prej rënies së komunizmit ka pasur disa parti politike në Shqipëri të cilat kanë deklaruar se përfaqësojnë interesat e minoritetit grek. Tradicionalisht minoriteti grek ka qënë i organizuar politikisht përmes Omonias (Greqisht: Bashkim) dhe i përfaqësuar nga Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ), parti kjo që ka qënë prezente në parlament në mënyrë të vazhdueshme, shpesh edhe në ekzekutiv. Një parti tjetër është Partia e Minoritetit Etnik Grek (M.E.G.A), e cila u krijua si rezultat i mungesës së konsensusit midis liderëve minoritar. Edhe partitë minoritare janë ndikuar

26. International Crisis Group (ICG). (2001). Albania: The State of the Nation 2001. *Balkans Report N°111*. Tirana/Brussels.

27. Për një qasje tjetër shihni: Human Rights Watch (1995). *Albania: The Greek Minority*, 7:4; and Barjarba, K. (2004): Migration and Ethnicity in Albania: Synergies and Interdependencies, in: *Brown Journal of World Affairs*, 11:1 (summer/fall 2004), pp. 231-9.

nga tendenca për përçarje ndërpartike ndërkohë që përpiqeshin të anonin majtas ose djathtas në përpjekje për t’u bërë pjesë e koalicioneve fituese.²⁸ Shpesh qytetarët shqiptarë i perceptojnë këto parti si vegla në duart e politikanëve në Athinë, perceptim ky që përforcohet nga media në vend.

Një shembull i shëmtuar i përzierjes së tensioneve etnike në politikat e partive dhe ato vendore sa herë është e udhës është rasti i komunitetit bilingual në Himarë ku “zgjedhjet fituese” barazohen tashmë me fitoret etnike.²⁹ Dërgimi i autobuzëve me grek në Himarë në raste zgjedhjesh vendore apo incidentet ku digjen flamujt ka kontribuar gjithashtu në një atmosferë tensionesh ndëretnike. Gjatë episodit të fundit të kësaj drame, partia ultra-nacionaliste Agimi i Artë dërgoi aktivistë për të themeluar një degë të saj në Himarë duke provokuar kështu një reagim të ashpër nga ana e shqiptarëve.³⁰

Varrezat e ushtarëve grek

Prej vitit 2008, Shqipëria dhe Greqia kanë një marrëveshje ku përcaktohet se Shqipëria merr përsipër të zhvillojë gërmime për të gjetur ushtarët grek të rënë gjatë luftës Italo-Greke, e cila u zhvillua pjesërisht në territorin shqiptar. Për më tepër, Shqipëria duhet të

28. Imeri, A. (2013). IBNA Special/2013 elections, Greek minority in Albania divided between SP and DP. *Independent Balkan News Agency*. Available at: <http://www.balkaneu.com/ibna-special2013-elections-greek-minority-albania-divided-sp-dp/>.

29. Barjarba, K. (2004): Migration and Ethnicity in Albania: Synergies and Interdependencies, in: *Brown Journal of World Affairs*, 11:1 (summer/fall 2004), pp. 231-9, <http://www.watsoninstitute.org/bjwa/archive/11.1/Essays/Barjarba.pdf> [6/21/2013].

30. Independent Balkan News Agency (2013). “Golden Dawn” in Himara, Police of Valona: Several Greek and Albanian nationals under investigation for national hatred. Available at: <http://www.balkaneu.com/golden-dawn-himara-police-valona-greek-albanian-nationals-investigation-national-hatred/>.

ndërtojë varreza përkujtimore për të gjeturit.³¹ Ndërkohë, nuk ka shifra ekzakte ose të përafërta të numrit të ushtarëve grek të rënë gjatë kësaj lufte në territorin shqiptar. I vetmi numër i raportuar deri më tani është ai i qeverisë greke që raporton 12 mijë ushtarë të rënë, një numër ky që konisderohet i tepruar në opinionin publik shqiptar.³² Për më tepër, akoma më pak i pranueshëm ka qënë në Shqipëri numri i vendndodhjeve të varrezave ushtarake të propozuara që ka kapur shifrën 669, duke nxitur nganjëherë debat edhe mbi terrenet e propozuara. Gjithashtu, nganjëherë incidente kanë ndodhur në varrezat ku po kryheshin gërmime apo kërkime. Një rast i tillë ka ndodhur së fundmi në Korçë ku kryetari i Omonias u akuzua për abuzime me varrezat e vjetra të një fshati shqiptar ndërkohë që po ndërtonte një përkujtimore për ushtarët grek të rënë në tokat shqiptare. Çështja ligjore nuk ka përfunduar akoma.³³

Censusi i popullsisë dhe pensionet greke

Retorika u ndez edhe njëherë në prag të censusit të popullsisë në 2011-ën në Shqipëri ku debati kryesor zhvillohej rreth përfshirjes ose jo të pyetjeve mbi etninë dhe fenë në pyetësorin përfundimtar. Çështja kryesore që u diskutua ishte nëse qytetarët shqiptar me etni shqiptare do ta identifikonin veten gjatë censusit si grekë në mënyrë që të klasifikoheshin si pjesë e minoritetit grek dhe për pasojë të përfitonin nga pensionet që ofronte shteti grek për

31. Papapostolou, A. (2010). President of Albania, orders the construction of cemeteries for Greek Soldiers. Independent Balkan News Agency. *Greek Reporter*. Available at: <http://eu.greekreporter.com/2010/04/15/president-of-albania-orders-the-construction-of-cemeteries-for-greek-soldiers/>.

32. Infoarkiv, (2014). *Zbulohet pakti për varrezat, Greqia: Janë 12 mijë ushtarë të vrarë në Shqipëri*. Online: <http://infoarkiva.com/lajme/artikull/iden/175083/titulli/Zbulohet-pakti-per-varrezat-Greqia-Jane-12-mije-ushtare-te-vrare-ne-Shqiperi>.

33. Gazeta Idea (2013). *Pas shpalljes te pafajshem te Naum Dishos, prokuroria apelon vendimin*. Online: <http://www.gazetaidea.com/pas-shpalljes-te-pafajshem-te-naum-dishos-prokuroria-apelon-vendimin/>.

minoritarët. PDIU-ja gjithashtu shfaqti shqetësime nëse ky census në fakt po përmbushte një axhendë të politikës greke.³⁴ Një parti politike që me siguri fitoi terren në mbështetjen popullore nga një retorikë e tillë ishte Aleanca Kuq e Zi, lideri i së cilës kishte etiketuar më parë çështjen e ndryshimit të emrave në gjykatë si dhe ndryshimin e qytetarisë.³⁵ Si pasojë e këtyre diskutimeve dhe shqetësimeve, në pyetësorin final, pyetja mbi etninë dhe fenë u paraqit si opsionale.

Ligji i luftës

I paqartë dhe tashmë pjesë e një mitizimi historik të kontekstit, ligji i luftës qëndron gjithashtu si një çështje e shumë diskutuar në debatin publik shqiptar kur bëhet fjalë për qëndrimet e Greqisë ndaj Shqipërisë. Një çështje sa burokratike aq edhe simbolike të paktën për shqiptarët, ligji i luftës u hoq zyrtarisht nga qeveria greke në vitin 1987,³⁶ megjithatë ai asnjëherë nuk u shfuqizua nga parlamenti grek. Greqia dhe Shqipëria janë pjesë e një Traktati bilateral Miqësie dhe Bashkëpunimi që prej vitit 1996. Ka pasur disa thirrje të njëpasnjëshme nga diplomatë shqiptarë për ta mbyllur këtë çështje përfundimisht në mënyrë që të dërgohet një sinjal pozitiv për përmirësimin e marrëdhënieve.³⁷

34. Agjencia Kombetare e Lajmeve NOA (2012). PDIU: Endrra e Athines: deklarimi i rreme i shqiptareve si greke. Online: <http://www.noa.al/artikull/censusi-pdiu-endrrat-e-athines-zyrtare-deklarimi-i-rreme-i-shqiptareve-si-greke/169108.html>.

35. Infoarkiv (2011). Refuzohet deklarimi i etnise dhe fese. Online: <http://infoarkiva.com/lajme/artikull/iden/1047111914/titulli/Refuzohet-deklarimi-i-etnise-dhe-fese>.

36. Evangelos Venizelos (Foreign Affairs Minister of Greece), Press statement on official visit to Tirana, 15 October 2013.

37. Shihni kërkesën e Ministrit aktual të Jashtëm, Z. Ditmir Bushati tek “Albania and Greece: tension about the Chams” <http://top-channel.tv/artikull.php?id=265607> dhe kërkesën e ish Ministrit të Jashtëm Edmond Panariti tek: “Albania Asks Greece to Declare War Finally Over” <http://www.balkaninsight>.

Njohja e Kosovës

Greqia, së bashku me Spanjën, Sllovakinë, Rumaninë dhe Qipron janë të vetmet vende të BE-së që nuk e njohin Kosovën si një shtet i pavarur. Ndërkohë që vendimi i Greqisë për të mos e njohur Kosovën është shpjeguar shpesh me marrëdhëniet e mira Greqi-Serbi; konsideratat më të gjera të Greqisë në lidhje me rajonin dhe stabilitetin e tij; frika e vetë Greqisë në lidhje me pretendimet në Qipron veriore; çështja më e gjerë e nacionalizmit shqiptar, “Shqipëria e Madhe” dhe shqetësime të tjera politike në lidhje me Ballkanin,³⁸ mund të japin një panoramë më të gjërë të arsyeve që e shtyjnë Greqinë të mbajë pozicionin aktual ndaj pavarësisë së Kosovës. Pavarësisht se Greqia nuk e njeh Kosovën, ky shtet e ka mbështetur dialogun Prishtinë-Beograd,³⁹ ka rregulla të veçanta për kosovarët që duan të vizitojnë Greqinë, ka marrëdhënie ekonomike në zhvillim me Kosovën⁴⁰ dhe për më tepër, Greqia ka qenë e pranishme në takimet rajonale ku Kosova ishte e ftuar në nivel qeveritar.

Në lidhje me marrëdhëniet Shqipëri-Greqi, çështja e Kosovës nuk

[com/en/article/albania-calls-on-greece-to-abolish-war-declaration](http://www.balkan.eu.com/en/article/albania-calls-on-greece-to-abolish-war-declaration). Gjithashtu, Presidenti shqiptar, Z.Bujar Nishani ka publikuar një deklaratë që mund të gjendet tek: <http://www.balkaneu.com/war-peace-albanian-grek-relations/>. Për një qasje më gjithëpërfshirëse të kësaj çështje shihni Vickers, M. (2002). The Cham Issue: Albanian National & Property Claims in Greece. *Conflict Studies Research Centre*. G 109.

38. Një qasje gjithëpërfshirëse për qëndrimin Grek në lidhje me Kosovën që prej luftës së vitit 1999 ofrohet nga

Armakolas, I. and Karabairis, A. (2012). “Greece – Kosovo: A complex relationship”, in *Kosovo Calling* (International Conference to Launch Position Papers on Kosovo’s Relation with EU and Regional Non-recognising Countries). Pp. 91-119.

39. Ministry of Foreign Affairs [Greece] (2014). Kosovo*: Political relations. Online: <http://www.mfa.gr/en/blog/greece-bilateral-relations/kosovo/>.

40. Ministry of Economic Development [Republic of Kosovo] (2013). Beqaj: Businesses, a promoter of Kosovo – Greece relations. Available at: <http://mzhe.rks-gov.net/?page=2,42,660>.

ka qënë qëndrore, edhe pse sërish e rëndësishme. Ndërkohë që Shqipëria ka lobuar vazhdimisht që numri i njohjeve të Kosovës të rritet, marrëdhëniet delikate dhe shumëdimensionale më Greqinë e kanë shtyrë çështjen e Kosovës në plan të dytë. Në anën tjetër, Greqia i ka lidhur qëndrimet e veta ndaj Kosovës me marrëdhëniet Greqi-Shqipëri më tepër sesa me ato Greqi-Serbi. Ish Ambasadori grek në Tiranë, Mallias, gjatë fjalës së tij në një konferencë të organizuar nga Instituti Shqiptar për Studimet Ndërkombëtare, ELIAMEP dhe nga Ambasada e Republikës Helene ka deklaruar se “do të ishte një gjë e mirë nëse Greqia do të shikonte interesat e veta përtej axhendës së përcaktuar nga Beogradi”, ndërkohë që vlerësonte se “është gjithashtu e sigurtë që në vitet e fundit pozicionet e shprehura në median shqiptare i kanë ndikuar negativisht politikat greke dhe opinionin publik grek e për pasojë kanë penguar edhe politikat greke ndaj Kosovës”.⁴¹ Së fundmi, gjatë vizitës së presidentit grek Papoulias në Tiranë, presidenti shqiptar Nishani i ka kërkuar në mënyrë eksplicite homologut të tij grek që vendi i tij të njohë pavarësinë e Kosovës.⁴²

41. “Greece and Albania : The framework and terms for a NEW DEAL “ by Ambassador (ad honorem) Alexandros Mallias, Speech, Conference by the Albanian Institute for International Studies, ELIAMEP and the Embassy of the Hellenic Republic (TIRANA, March,27 2012)

42. B92 (2013). Albania “wants Greece to recognize Kosovo”. Available at: http://www.b92.net/eng/news/region.php?yyyy=2013&mm=11&dd=05&nav_id=88240.

Objektivi i sondazhit

Qëllimi i këtij studimi është të hidhet dritë mbi perceptimet bashkëkohore që kanë qytetarët shqiptarë që jetojnë në Shqipëri për grekët, politikat shtetërore të Greqisë dhe në përgjithësi marrëdhëniet e Greqisë me Shqipërinë. Këto perceptime në vetvete janë formësuar prej disa faktorëve. Së pari dhe çka është më e rëndësishme, ato janë formësuar nga retorika politike e politikanëve shqiptarë dhe ndërveprimet e tyre me homologët grek. Ato janë formësuar gjithashtu nga mbulimi mediatik, interpretimi dhe analiza e çështjeve të ndryshme që kanë ndodhur dhe kanë përfshirë të dy vendet si edhe banorët e tyre. Por më së shumti, ato janë formësuar nga ndërveprimi i drejtpërdrejtë për shkak të emigrimit. Edhe ata shqiptarë që nuk kanë qenë emigrantë në Greqi kanë patur miq të ngushtë apo të afërm që kanë jetuar apo ende jetojnë atje. Së fundi, por jo për nga rëndësia, perceptimet janë formësuar nga ekzistenca historike e minoritetit grek, veçanërisht në jug të Shqipërisë që kanë bashkeekzistuar paqësisht përgjatë gjithë këtyre viteve.

Perceptimet i përgjigjen gjithashtu retorikës së përforcuar dhe medias pasi ato kanë më pak nuanca dhe po bëhen më aggressive. Në sondazhet që zhvillon Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare, kur qytetarët pyeten rreth vendeve që përbëjnë rrezik për Shqipërinë përgjigja e zakonshme e tyre ishte Serbia. Megjithatë, pasi politikanët nacionalistë shqiptarë filluan ta drejtojnë gishtin tek Greqia si problem për integritetin territorial të Shqipërisë, qytetarët u ndikuan menjëherë. Në sondazhet e kryera vitin e kaluar, AHS vuri re se shumica e qytetarëve shqiptarë që besojnë se ekziston një rrezik për Shqipërinë, përmendin Greqinë si burimin e këtij rreziku. Në vitin 2011, nga i gjithë kampi, 18 përqind e qytetarëve besonin se siguria e Shqipërisë kërcënohej dhe prej tyre

47.9 përqind besonte se rreziku vinte nga Greqia dhe 51.6 përqind identifikuan Serbinë.⁴³ Ndërkohë që në vitin 2013 “nga një e treta e kampionit që identifikojnë një rrezik për Shqipërinë, shumica, ose 55.8 përqind besojnë se ky kërcënim paraqitet nga Greqia dhe 24.3 përqind mendon se kërcënimi është Serbia. Vendet e tjera të përmendura kanë vlerë të ulët ose nuk janë aspak të rëndësishëm nga ana statistikore.”⁴⁴

Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare duke njohur nevojën për matjen e pulsit të qytetarëve ka zhvilluar një sondazh kombëtar me një kampion përfaqësues në mënyrë që të identifikojë perceptimet e opinionit publik, vlerësimet, shqetësimet dhe pritshmëritë rreth të ardhmes së marrëdhënieve ndërmjet këtyre dy vendeve si edhe të identifikojë çështjet që ndikojnë tek kjo marrëdhënie si edhe faktorët që ndikojnë në krijimin e perceptimeve tek publiku. Duke e bërë këtë AIIS prezanton një sërë të dhënash të vlefshme për politikbërësit që të përcaktojnë dhe adresojnë çështjet specifike sipas rëndësisë së tyre duke i kombinuar këto ndërkohë me kontekstualizimin e nevojshëm.

43. “Albania twenty years after: People on state and democracy”, AIIS: Tirana 2011, pg 76.

44. “The state of democracy in Albania before the 2013 elections”, AIIS; Tirana 2013.

Përmbledhje ekzekutive

Vlerësime të përgjithshme

Ndërkohë që shumica e shqiptarëve besojnë se marrëdhëniet ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë janë thjesht normale, ekziston një simetri tek të dy grupet që i konsiderojnë marrëdhëniet të mira dhe të këqija, me respektivisht më tepër se një e katërta e përgjigjeve për secilën.

Duket se shqiptarët besojnë që qeveritë e Shqipërisë dhe Greqisë kanë marrëdhënie më të mira me njëra-tjetrën krahasuar me marrëdhënien që kanë njerëzit e njërës vend me tjetrin. Ndërkohë që 52 përqind e shqiptarëve besojnë se marrëdhëniet ndërmjet qeverisë greke dhe asaj shqiptare janë normale, vetëm 42 përqind thonë të njëjtën gjë për marrëdhëniet ndërmjet grekëve dhe shqiptarëve. Në mënyrë të ngjashme, ndërkohë që vetëm 15 përqind e qytetarëve besojnë se marrëdhëniet ndërmjet qeverive është e keqe apo shumë e keqe, numri i atyre që besojnë se marrëdhëniet ndërmjet njerëzve janë në gjendje të keqe arrin në 28 përqind, afër një të tretës së kampionit.

Shumica dërmuese prej 76 përqind në Shqipëri beson se marrëdhëniet me Greqinë kanë rëndësi të konsiderueshme. Pjesa e atyre që nuk i japin fare rëndësi kësaj marrëdhënieje është shumë e vogël, vetëm 5 përqind ndërkohë që pjesa tjetër mendon që ka më pak rëndësi.

Në një masë të madhe, rreth 41 përqind e kampionit, shqiptarët besojnë se marrëdhëniet me Greqinë nuk kanë ndryshuar shumë dekadën e fundit krahasuar me periudha të mëparshme. Megjithatë, një shifër e konsiderueshme prej 35 përqind besojnë se këto marrëdhënie janë përmirësuar ndërkohë që 22 përqind besojnë që këto janë përkeqësuar. Ata janë mjaft optimistë që këto marrëdhënie do të përmirësohen në

të ardhmen, një opsion që përmendet nga 44 përqind e kampionit krahasuar me 37 përqind të atyre që mendojnë se do të mbeten pak a shumë të njëjta. Megjithatë, një në dhjetë qytetarë thotë se marrëdhëniet do të përkeqësohen në të ardhmen.

Çështje të rëndësishme

Duket se ka tri “thembra Akili” në marrëdhënien ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë sipas opinionit të qytetarëve shqiptarë dhe shumica e atyre që do të ndodhin në marrëdhëniet ndërmjet të dy vendeve do të varen tek progresi i arritur në adresimin apo njohjen e tyre: fillimisht dhe çka është më e rëndësishme çështja e kufijve me marrëveshjen mjaft të rëndësishme të kufirit bregdetar, së dyti, çështja çame, që ende nuk është njohur si çështje nga ana greke dhe së fundi trajtimi i emigrantëve shqiptarë të shumtë në numër, që jetojnë në vendin fqinj jugor. Këto ndiqen nga çështja e pranisë së minoritetit grek në Shqipëri si edhe partitë politike dhe zhvillimet që lidhen me të si edhe kryesimi i Kishës Ortodokse Shqiptare nga Kryepeshkopi grek Janullatos, një çështje e nxehtë kjo që gjendet gjithnjë në median dhe retorikën politike në Shqipëri.

Pothuajse gjysma e shqiptarëve përmendin si çështjen më të rëndësishme atë të kufirit detar, me 49 përqind të përgjigjeve. Çështja e dytë që citohet më tepër është çështja çame, me 29 përqind, që ka marrë pikë të konsiderueshme si prioriteti i dytë nga 21 përqind dhe si prioriteti i tretë nga 27 përqind e të anketuarve.

Influencë apo kërcënim

Shumica dërrmuese e shqiptarëve përmendin Shtetet e Bashkuara të Amerikës si vendin me influencën më të madhe mbi Shqipërinë

duke lënë vetëm 2 përqind për ata që besojnë se Greqia ka qenë një prej vendeve me influencë më të madhe. Pothuajse një në pesë shqiptarë beson se Greqia përbën rrezikun më të madh të sigurisë për Shqipërinë.

Gjysma e të anketuarve beson se qeveria shqiptare duhet t'i kushtojë vëmendje të madhe Greqisë dhe të përpiqet të zhvillojë marrëdhëniet me këtë vend.

Shumica e të pyeturve, rreth 53 përqind, besojnë se marrëdhëniet ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij grek kanë qenë dhe ende kanë mbetur të mira ose edhe shumë të mira. Një grup i fuqishëm prej 40 përqind i cilëson marrëdhëniet si normale dhe vetëm një grup i vogël prej 6 përqind mendon se këto janë problematike.

Në një numër shumë të madh, shqiptarët besojnë se qeveria e tyre po bën punë të mirë sa i përket respektimit të të drejtave të minoritetit grek sipas standardeve ndërkombëtare. Megjithatë ekziston një lloj ndarjeje, prirja e publikut shqiptar është të mendojë se Greqia ushtron influencë tek Shqipëria përmes Kishës Ortodokse por edhe më tepër përmes partive politike që përfaqësojnë minoritetin grek.

Më tepër njerëz besojnë se Greqia është në luftë, të paktën ligjërisht, me Shqipërinë se ata që thonë të kundërtën. Pothuajse të gjithë shqiptarët mendojnë se dështimi në zgjidhjen e çështjes çame është një pengesë e madhe në rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë.

Njerëzit janë të ndarë sa i përket çështjes nëse grekët e mbështesin Shqipërinë në integrimin evropian ndërkohë që ata vëzhgojnë se qeveria greke nuk po ndihmon shumë me këtë çështje specifike. Shumica e shqiptarëve nuk dinë asgjë rreth Traktatit të Miqësisë ndërmjet të dy vendeve ndërkohë që shumica paradoksisht beson se të dy vendet kanë qenë në luftë me njëri-tjetrin në të shkuarën.

Shqiptarët duan të marrin meritat për zhvillimin ekonomik të Greqisë, duke pretenduar se kanë kontribuar tek ky zhvillim por duke e pranuar gjithashtu se Greqia e ka ndihmuar Shqipërinë gjatë periudhës së tranzicionit.

Grupe të ngjashme prej 44 përqind secili, besojnë se marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë në frontin ekonomik janë të mira/ shumë të mira dhe normale. Një pjesë e madhe e publikut, 40 përqind, mendon se përfitimet e kësaj marrëdhënieje kanë qenë reciproke ndërkohë që të tjerët kanë perceptime më të anuara duke besuar se Greqia ka përfituar më tepër apo ka qenë e vetmja përfituese nga ndërveprimi ekonomik me Shqipërinë. Një e dhjeta e kampionit beson se Shqipëria ka qenë në fakt pala që ka përfituar më shumë.


Publiku shqiptar tregon nivele të larta ndërgjegjësimi sa i përket krizës financiare dhe ekonomike në Greqi duke shprehur vlerësimin e tij mbi impaktin e saj negativ tek situata e emigrantëve shqiptarë atje, niveli i remitancave dhe pozita e bizneseve greke në Shqipëri.

Jetesa e përbashkët

Shqiptarët kanë nivele të larta eksperiencash të drejtpërdrejta dhe dije rreth Greqisë duke patur parasysh se 57 përqind e tyre e kanë vizituar Greqinë të paktën një herë dhe më tepër se çereku i të pyeturve në këtë sondazh kanë jetuar apo punuar në Greqi për një kohë relativisht të gjatë (prej dy ose më tepër vitesh). Pjesa më e madhe e atyre që kanë jetuar në Greqi e përshkruajnë eksperiencën e tyre me qytetarët grek si normale ose të mirë ndërkohë që një numër i vogël raporton probleme gjatë qëndrimit atje. Gjysma e të anketuarve të pyetur në këtë sondazh kanë të afërm apo miq që jetojnë aktualisht në Greqi, tregues ky i nevojës për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet të dy vendeve.

Gjetjet dhe analiza


Vlerësimi i përgjithshëm i marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë ofron rezultatet në vijim: 45 përqind e qytetarëve besojnë se këto marrëdhënie janë normale. Rreth 22 përqind besojnë se ato janë në gjendje të keqe dhe një grup i vogël prej 5 përqind thonë se janë në gjendje shumë të keqe. Në mënyrë të ngjashme 27 përqind besojnë se marrëdhëniet janë të mira apo mjaft të mira të ndarë respektivisht në 21 dhe 6 përqind.




E njëjta simetri vërehet edhe kur njerëzit pyeten më specifikisht për marrëdhëniet ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj greke. Një shumicë prej 52 përqind përgjigjen se marrëdhëniet janë normale në këtë rast. Nga ana tjetër, 27 përqind besojnë se këto marrëdhënia janë të mira ose shumë të mira me numrin e atyre që i shohin këto marrëdhënia si të këqija që qëndron në nivele të ulëta. Në të vërtetë vetëm 12 përqind thonë se marrëdhëniet ndërmjet qeverive janë

të këqija dhe vetëm një 3 përqindësh i papërfillshëm besojnë se ato janë shumë të këqija. Këto shifra bëhen edhe më treguese kur krahasohen me pyetjen pasardhëse mbi marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe grekëve, pra ndërmjet popullsisë të të dy vendeve.


Marrëdhëniet midis Qeverisë së Shqipërisë dhe të Greqisë




Marrëdhëniet midis shqipëtarëve dhe grekëve




Në këtë rast vetëm 41 përqind besojnë se marrëdhëniet janë normale, duke sinjalizuar një rënie prej 10 pikësh krahasuar me vlerësimin e dhënë për marrëdhëniet ndërmjet qeverive. Kështu, më tepër njerëz besojnë se marrëdhëniet ndërmjet njerëzve janë të këqija ose shumë të këqija, një total prej 27 përqind. Në anën tjetër, 30 përqind besojnë se marrëdhëniet janë ose të mira ose shumë të mira. Duket se ekziston një mospërputhje në perceptimin e qytetarëve, duke qenë se ata besojnë që marrëdhëniet ndërmjet popullsisë janë më të këqija se marrëdhëniet ndërmjet qeverive përkatëse.



Një shumicë prej 53 përqind i vlerëson marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë me rëndësinë e duhur duke thënë se ato janë të “rëndësishme”. Rreth 23 përqind besojnë se këto marrëdhënie janë shumë të rëndësishme ndërkohë që 19 përqind thonë se kanë pak rëndësi dhe vetëm 5 përqind besojnë se nuk kanë aspak rëndësi.



Nga krahasimi i marrëdhënieve ndërmjet të dy vendeve me periudha të mëparshme, shumica e qytetarëve shqiptarë duket se besojnë se nuk ka patur shumë ndryshime, me 41 përqind që thonë se kanë



mbetur njësoj. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme prej 35 përqind besojnë se dekadat e fundit marrëdhëniet janë përmirësuar në shumë nivele, dhe vetëm 22 përqind thonë se ka patur përkeqësim.

Sa i përket pritshmërive për të ardhmen shqiptarët mbeten optimistë. Rreth 44 përqind e qytetarëve thonë se marrëdhëniet ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë me siguri do të përmirësohen në të ardhmen ndërkohë që 37 përqind mendojnë se ato do të mbeten pak a shumë njësoj. Vetëm një në dhjetë qytetarë beson se marrëdhëniet do të përkeqësohen dhe në mënyrë të ngjashme 9 përqind e kampionit nuk i përgjigjet kësaj pyetjeje.

Çështje të rëndësishme sipas rradhës

Të pyetur të identifikojnë dhe rendisin sipas rëndësisë çështjet që ndikojnë tek marrëdhëniet ndërmjet të dy vendeve, qytetarët zgjedhin tri probleme kryesore që duhen adresuar: çështja e kufijve, çështja çame dhe trajtimi i emigrantëve shqiptarë në Greqi. Këto ndiqen nga çështje që lidhen me minoritetin grek në Shqipëri si edhe prania e kryepeshkopit Janullatos si kryetar i Kishës Ortodokse.

Çështja më e rëndësishme që përmendet më shpesh dhe që ndikon tek marrëdhëniet ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë është ajo e kufijve. Ky perceptim publik është influencuar shumë nga mbulimi mediatik i kohëve të fundit mbi marrëveshjen për kufirin bregdetar (për përcaktimin e kufijve përkatës detarë), një marrëveshje e nënshkruar nga Bakojanis dhe Basha dhe që është konsideruar antikushtetuese dhe për rrjedhojë u deklarua e pavlefshme në Shqipëri nga Gjykata Kushtetuese. Termet narrativë në të cilët kjo çështje u trajtua përfshinin fjalë të tilla si “tradhti”, “shitje e detit”, “pabesi”, “vjedhje e detit” etj. Gjenerali në pension që e denoncoi këtë marrëveshje pasi ishte e paligjshme, Myslym Pashaj u zgjodh si

personi më influencues i vitit nga një sondazh televiziv.⁴⁵

Opsionet	Zgjedhur çështja prioritare numër 1	Zgjedhur çështja prioritare numër 2	Zgjedhur çështja prioritare numër 3
Çështjet e kufirit	46%	19%	20%
Minoriteti grek	10%	25%	12%
Çështja çame	21%	29%	27%
Prania e kryepeshkopit Janullatos në krye të Kishës Ortodokse	2%	7%	9%
Trajtimi i emigrantëve shqiptarë në Greqi	19%	19%	30%

Konteksti në të cilin përmendet minoriteti grek në Shqipëri ka të bëjë më pak me praninë e tyre tradicionale, veçanërisht në jug dhe më tepër me përfaqësimin e tyre nga partitë politike, lidhja e tyre e dyshuar me politikanët grek dhe çështja e pensione greke. Në të vërtetë, përgjigjet e ofruara ndaj një tjetër pyetjeje reflektojnë shumë mirë faktin që shqiptarët i konsiderojnë optimale marrëdhëniet e përditshme ndërmjet minoritetit grek dhe qytetarëve shqiptarë.


Mund të argumentohet bindshëm se çështja e trajtimit të emigrantëve në Greqi do të kishte patur më tepër rëndësi nëse sondazhi do të kryhej në vitet 90'. Megjithatë shumë probleme janë të pranishme ende sot, emigrantët shqiptarë kanë arritur të plotësojnë një proces relativisht të suksesshëm integrimi duke çuar kështu në më pak incidente dhe më pak tension me vendin e tyre pritës. Kjo është reflektuar gjithashtu tek opinioni publik.

Nga përgjigjet sporadike të dhëna për çështje të tjera, shumë pak prej tre përmendin ligjin e luftës ose shkëmbimet tregtare ndërmjet të dy vendeve.


45. Top Channel: 2010. Shih gjithashtu “ Why Albanians picked Myslim Pashaj as the person of the year” <http://www.people.al/pse-shqiptaret-zgjodhen-myslim-pashen-personazhi-i-vitit-2010.html>

Duke i vendosur marrëdhëniet në një kontekst krahasues, shqiptarët nuk besojnë se influenca e ushtruar nga Greqia në territorin e tyre është thelbësore. Në të vërtetë, të pyetur për vendin që ka patur influencën më të madhe tek Shqipëria këto dy dekadat e fundit, më tepër se gjysma e të anketuarve, 54.3 përqind kanë identifikuar Shtetet e Bashkuara, ndjekur nga 29 përqind që identifikojnë BE-në si entiteti që ushtron më tepër influencë. Pothuajse 5 përqind e përgjigjeve i referohen Italisë dhe vetëm 2 përqind besojnë se vendi më influencues ka qenë Greqia.

Ky rezultat nuk duhet të ngatërrohet si refuzim i influencës së këtij vendi. Sikurse tregohet nga përgjigje të tjera. Shqiptarët besojnë se Greqia ushtron influencë tek Shqipëria përmes partive politike minoritare, kryetarit të Kishës Ortodokse etj. Megjithatë, ato besojnë se krahasuar me vende të tjera ose entitete të tjera si për shembull Shtetet e Bashkuara apo BE-ja, kjo influencë është krahasimisht më e vogël.




Një panoramë ndryshe paraqitet nga përgjigjet që janë dhënë në lidhje me identifikimin e kërcënimeve. Edhe pse pothuajse gjysma e të anketuarve ndjehen të sigurt dhe nuk besojnë se ndonjë vend paraqet rrezik për Shqipërinë, nga 54.6 përqind e atyre që e ndjejnë këtë kërcënim, nëngrupi më i madh beson se kërcënimi është në fakt Greqia. Rreth 18.5 përqind e qytetarëve kanë zgjedhur Greqinë si vendin që përfaqëson rrezik ndjekur nga 17 përqind që zgjedhin Serbinë dhe 14 përqind që nuk kanë një përgjigje. Një grup shumë i vogël prej 2 përqind zgjedhin Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (që në Shqipëri njihet thjesht si Maqedoni), si një vend që paraqet rrezik për Shqipërinë.




Në një shkallë nga 1 në 10, ku 1 përfaqëson zero rëndësi dhe 10 rëndësi maksimale, qytetarët vlerësuan shkallën e përpjekjeve dhe përkushtimit që qeveria shqiptare duhet t'i dedikojë marrëdhënieve me secilin prej vendeve fqinje. Sikurse tregon grafiku i mëposhtëm,

shumica e shqiptarëve besojnë se rëndësi më e madhe i duhet kushtuar marrëdhënies me Kosovën, ndjekur nga Italia dhe më pas Greqia. Në përgjithësi, qytetarët shqiptarë janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e marrëdhënieve Shqipëri-Greqi dhe shumica e përgjigjeve bie në shkallën 8-10 të vlerësimit, që tregon një nivel të lartë rëndësie. Më pas se një e pesta e kampionit beson se marrëdhëniet meritojnë një vëmendje më të ulët se mesatarja (shkalla e vlerësimit 1-4).

Marrëdhëniet me Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë vendosen në rreshtin e dytë, me nivele të ndryshme rëndësie që qytetarët i asociojnë atyre.



Një pyetje e rëndësishme kishte si qëllim analizimin e vlerësimit që shqiptarët kanë për marrëdhëniet që kanë ekzistuar ndërmjet shqiptarëve dhe komuniteteve greke historike të fokusuar në jug të Shqipërisë. Është thelbësore të theksohet fakti që më tepër se gjysma e qytetarëve të intervistuar besojnë se marrëdhënia ka qenë dhe vijon të jetë e mirë ose shumë e mirë. Një total prej 53.3 përqind pati vlerësim pozitiv të marrëdhënies, prej të cilëve 31.6 përqind i konsiderojnë ato “të mira” dhe 21.7 përqind “shumë të mira”. Për më tepër, 37.5 përqind i konsiderojnë marrëdhëniet si normale dhe vetëm 7.2 përqind besojnë se ajo ka qenë e keqe apo shumë e keqe me këtë kategorinë e fundit që përfaqëson një grup statistikisht të pakonsiderueshëm prej 1 përqind.



Perceptimet

Qytetarët u prezantuan me një sërë deklaratash që përfaqësojnë disa pohime, si fakte ashtu edhe keqperceptime të përgjithshme që lidhen me marrëdhëniet historike dhe ato aktuale ndërmjet qeverisë shqiptare dhe greke ose njerëzit përkatës, në mënyrë që ato të shprehin vlerësimin e tyre për pohimet si të vërteta apo të gabuara. Ky ushtrim u bë me qëllim që të identifikoheshin dhe theksohej ekzistenca si edhe shkalla e disa keqperceptimeve, perceptimeve të fuqishme dhe paragjykimeve që janë të përhapura në opinionin publik shqiptar. Kjo do të çojë eventualisht në një sërë rekomandimesh për të zhbërë këto keqperceptime për të përmirësuar kështu njohuritë dhe perceptimet për njëri-tjetrin.

Për të shpjeguar gjykimin e shqiptarëve se marrëdhënia e tyre me minoritetin grek që jeton në Shqipëri është e mirë ose normale shërben fakti që një shumicë shqiptarësh janë të bindur se qeveria e tyre ndjek dhe respekton standardet ndërkombëtare kur vjen puna tek trajtimi i këtij minoriteti. Ndaj, 78 përqind e atyre të pyetur e besonin këtë ndërkohë që vetëm 9 përqind thanë se qeveria nuk i respekton standardet e lartpërmendura. Pothuajse një në dhjetë të anketuar (12 përqind) nuk mund të përgjigjej nëse ky pohim ishte i vërtetë apo i gabuar.

Pothuajse gjysma e qytetarëve të pyetur besojnë se Greqia ndërhyr në punët e brendshme të Shqipërisë përmes kreut të Kishës Ortodokse. Rreth 45 përqind e kampionit beson se një lloj influence dhe ndërhyrjeje ushtrohet përmes Kryepeshkopit Janullatos si kreu i një prej emërtimeve më të rëndësishme të krishtera në Shqipëri, ndërkohë që 32 përqind ishin kundër kësaj deklarate duke besuar se është e gabuar. Një numër i konsiderueshëm të anketuarish, që përbën rreth një të katërtën e kampionit (23 përqind), nuk kishte ndonjë opinion në

lidhje me deklaratën, duke treguar kështu një dyshim ose thjesht hutim të përgjithshëm rreth pohimit.

Edhe më i theksuar duket se është perceptimi ndërmjet qytetarëve shqiptarë rreth ndërhyrjes greke në Shqipëri përmes përdorimit të minoritetit grek. Ndaj, këtë herë, më tepër se gjysma e kampionit, 54 përqind e të pyeturve, besojnë se ‘Greqia ndërhyr në punët e brendshme të Shqipërisë përmes minoritetit grek’, ndërkohë që vetëm 26 përqind e konsiderojnë të pavërtetë këtë deklaratë. Sërish, një numër i madh të anketuarish, 21 përqind, nuk e dinë përgjigjen e kësaj pyetjeje duke treguar kështu dyshim ose hutim.

Një prej çështjeve që pengon marrëdhëniet normale ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë dhe ushtron influencë të konsiderueshme tek opinioni publik shqiptar është ajo e “ligjit të luftës”. Ndaj, pavarësisht faktit që ligji i luftës është abroguar nga qeveria greke edhe para rënies së regjimit komunist megjithëse nuk është miratuar nga parlamenti, një shumicë e qartë shqiptarësh, 61 përqind, besojnë se Greqia është ende në gjendje lufte me Shqipërinë. Vetëm 17 përqind e të anketuarve thonë se të dy vendet nuk janë në luftë ndërkohë që 22 përqind e kampionit nuk e dinë nëse kjo është e vërtetë ose jo. Është e rëndësishme të theksohet se në jetën e tyre të përditshme shqiptarët mund të shohin se vendi i tyre nuk është në luftë me Greqinë por ky pohim vjen drejtpërdrejtë si reagim ndaj mediatizimit të tepruar të çështjes së ligjit të luftës. Situata bëhet edhe më komplekse nga përqindja e ulët e qytetarëve që janë të ndërgjegjshëm për Traktatin e Miqësisë dhe Bashkëpunimit që ekziston ndërmjet të dy vendeve që prej vitit 1998. Vetëm 36 përqind e qytetarëve beson tek ekzistenca e këtij traktati, ndërkohë që një shifër e ngjashme nuk ka asnjë informacion rreth tij. Për më tepër, një numër i konsiderueshëm qytetarësh, pothuajse një e treta e kampionit (28 përqind) janë të bindur se një traktat i tillë nuk ekziston.

Vlerësimi i marrëdhënies së luftës shtrihet qartësisht tek e shkuara, ku shumica e shqiptarëve thonë se grekët dhe shqiptarët kanë luftës

kundër njëri-tjetrit, pretenduar nga 54 përqind. Në të njëjtën kohë është interesante se një pjesë e konsiderueshme prej 36 përqind thonë se shqiptarët dhe grekët nuk kanë luftuar kurrë me njëri-tjetrin ndërkohë që një e dhjeta e kampionit nuk e ka informacionin për këtë çështje.

Elefanti tjetër i madh në dhomë është çështja çame dhe këmbëngulja e palës greke për ta trajtuar këtë çështje si jo-çështje, duket se e përkeqëson perspektivën e gjetjes së një rruge të mesme. Në perceptimin e shumicës dërrmuese të qytetarëve shqiptarë, më tepër se 80 përqind “dështimi në gjetjen e një zgjidhjeje për çështjen çame është pengesë e madhe për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë”. Vetëm 12 përqind nuk beson tek ky pohim ndërkohë që një minoritet prej 7 përqind nuk ofron ndonjë opinion për këtë çështje.


Kur vjen puna tek perspektiva e integritit të Shqipërisë brenda Bashkimit Evropian, opinioni publik shqiptar është i fragmentuar dhe përgjithësisht skeptik për mbështetjen greke. Ndaj, të pyetur nëse qytetarët në Greqi do të mbështesnin integritimin e Shqipërisë, vetë shqiptarët duken të ndarë në tre grupe pothuajse të barabarta, me ata që besojnë tek mbështetja greke, ata që i frikësohen reagimit negativ dhe ata që nuk e dinë. Me një avantazh mjaft të vogël, 37 përqind e shqiptarëve beson se qytetarët grek nuk e mbështesin këtë aspiratë të Shqipërisë, ndërsa 30 përqind është grupi që nuk ka një opinion të qartë për këtë çështje.

Edhe më i zyrtë duket perceptimi nëse qeveria greke e ka ndihmuar Shqipërinë në përpjekjet e saj drejt integritit evropian. Në këtë rast, një shumicë qytetarësh, 46 përqind, beson se qeveria greke nuk ka ndihmuar aspak ndërkohë që 35 përqind besojnë se ajo ka ndihmuar. Nga ana tjetër 18 përqind nuk dinë si të përgjigjen.

Qytetarët shqiptarë kanë konsiderata të larta për kontributin e tyre


tek ekonomia greke me një shumicë prej 82 përqind që beson se është e vërtetë që Shqipëria e ka ndihmuar ekonominë greke dhe vetëm 13 përqind që besojnë se kjo nuk është e vërtetë. Vlerësimi që shqiptarët kanë për kontributin e emigrantëve shqiptarë në Greqi, por edhe përfitimet e perceptuara nga investimet greke dhe tregtia me Shqipërinë, janë mjaft domethënëse. Vetëm 5 përqind e kampionit nuk kanë një opinion mbi këtë deklaratë.

Në fund të fundit bie mjaft në sy që pavarësisht ndjenjave negative dhe perceptimeve të fuqishme, një shumicë e konsiderueshme e shqiptarëve beson që në fakt Greqia e ka ndihmuar Shqipërinë në 20 vitet e fundit. Rreth 56 përqind e qytetarëve besojnë se një ndihmë e tillë është realitet ndërkohë që 37 përqind nuk mund të ofrojnë një përgjigje të qartë. Fakti që më tepër se gjysma e qytetarëve e vlerësojnë asistencën greke si pozitive në vitet e vështira dhe vendimtare të tranzicionit ekonomik dhe politik të Shqipërisë është një bllok mjaft i rëndësishëm për ndërtimin e marrëdhënieve konstruktive në të ardhmen.




Marrëdhënia ekonomike

Shqiptarët e vlerësojnë marrëdhënien ekonomike midis Greqisë dhe Shqipërisë me terma mjaft pozitive, rreth 44 përqind e vlerësojnë këtë marrëdhënie si normale dhe 44 përqind të tjerë, nga të cilët thonë se është mirë (35 përqind) ose shumë mirë (grup i vogël prej 9 përqind). Një minoritet prej 7 përqind mendojnë se kjo marrëdhënie është e keqe, kurse 5 përqind nuk e dinë.



Gjithsesi kur dikush thellohet për të parë përshtypjen dhe pyet qytetarët të tregojnë kush janë ata që kanë përfituar më shumë nga lidhjet ekonomike, perceptimet tregojnë trende interesante

dhe me lëkundje të konsiderueshme. Prandaj, ndërsa 40 përqind duket se besojnë se të dy vendet kanë qenë pak a shumë përfitues të barabartë, 29 përqind mendojnë se në fakt Greqia ka përfituar me shumë se Shqipëria, ndërsa një grup tjetër më agresiv prej 10 përqind mendon se Greqia është e vetmja përfituese. Vetëm 9 përqind mendojnë se Shqipëria ka përfituar më shumë dhe një përqindje e papërfillshme, prej 3 përqind, vënë Shqipërinë si përfituesen e vetme të kësaj marrëdhënieje. Ndërkohë 9 përqind të tjerë nuk e kanë vlerësuar pyetjen dhe janë përgjigjur ‘nuk e di’.




Shqiptarët mbeten të vetëdijshëm për pasojat që kriza ekonomike dhe financiare për fqinjët e tyre jugore ka në tre çështje shumë të rëndësishme: trajtimin dhe situatën e përgjithshme të emigrantëve, remitancat dhe investimet Greke në Shqipëri. Opinioni publik në Shqipëri qëndron i bashkuar mendimit mbi gjykimin e ndikimit

negativ që ka patur kriza në këto tre çështje, megjithatë ndikimi negativ që perceptohet për investimet Greke në Shqipëri duket i ulët. Kështu 85 përqind thonë se kjo krizë me të vërtetë ka pasur një ndikim negativ në situatën e shqiptarëve që banojnë si emigrantë në Greqi, ndërsa vetëm 8 përqind nuk e shohin një ndikim të tillë negativ.


Në mënyrë të ngjashme 85 përqind besojnë se është kriza, e cila ka ndikuar në rënien e remitancave duke thënë se ajo ka pasur një ndikim negativ në shumën e remitancave të dërguara në shtëpi. Vetëm 10 përqind thonë se një ndikim i tillë nga remitancat nuk ekziston.

Më e rëndësishmja, 68 përqind e shqiptarëve besojnë se kriza ka ndikuar negativisht në investimet Greke në Shqipëri, por këtu një pjesë shumë e konsiderueshme prej 19 përqind, pothuajse një e pesta e kampionit, besojnë se investimi Grek në Shqipëri nuk është dëmtuar nga kriza.




Kontakte Miqësore

Në një seri pyetjesh që tregojnë sa afër janë kontaktet njerëzore dhe atë që ka dalë nga përgjigjet e shqiptarëve tregojnë një shkallë shumë të lartë kontaktesh të ngushta me Greqinë, kanë qenë atje në vizita me qëllime të ndryshme, duke pasur familje apo gjejnë banim atje apo edhe duke jetuar dhe kane punuar aty për veten e tyre për vite me radhë. 57 përqind e shqiptarëve kanë vizituar Greqinë të paktën një herë. Dhe vetëm 43 përqind e të anketuarve thanë se ata kurrë nuk kishin qenë në Greqi.




Prej atyre që kanë vizituar Greqinë shumica e ka bërë këtë me qëllim të takimit të familjare të tyre, të afërmeve apo miqve. Prandaj 29 përqind tregojnë se qëllimi i vizitës së tyre ka qenë ky. Megjithatë grupe po kaq të mëdha, prej 27 përqind tregojnë se kanë qenë atje

për të punuar apo për të kaluar pushimet e tyre. Një grup më i vogël prej 4 përqind ka qenë në Greqi për arsye mjekësore ose për të kërkuar trajtim në spitalet greke. Një e dhjeta e të anketuarve nuk thonë se cili ka qenë qëllimi i vizitës së tyre.




Një grup i madh i atyre i të intervistuar raportojnë se kanë shpenzuar të paktën dy vjet duke jetuar dhe punuar në Greqi në dy dekadat e fundit që korrespondojnë me periudhën e tranzicionit të Shqipërisë. Kështu 26 përqind e të intervistuarve, që korrespondon me një të katërtën e të anketuarve, kanë qenë ose janë aktualisht rezidentë në Greqi dhe kanë punuar atje. Ky nën grup është zhytur kështu më thellë në shoqërinë greke dhe përvoja e tyre është shumë e dobishme për të studiuar se si ajo zbulon perceptimet që


janë formuar edhe për shkak të kontakteve të tyre personale dhe jetën e tyre të drejtpërdrejtë dhe jo vetëm përmes ndikimit indirekt të kolegëve apo mediave.



Prej këtij grupi qytetarësh, që kanë shpenzuar më shumë se 2 vjet në Greqi, vlen të theksohet rëndësia se shumica e tyre vlerësojnë përvojën e tyre personale dhe marrëdhëniet e tyre me grekët gjatë kësaj periudhe qëndrojnë si të mira ose shumë të mira, me në një total prej 45 përqind. Ndërkohë 28 përqind thonë se marrëdhënia është normale ndërsa vetëm 6 përqind kane përshkruar përvojën e kësaj marrëdhënie të keqe ose shumë të keqe. Kjo është një tjetër shenjë e nivelit të suksesshëm të integritimit të emigrantëve shqiptarë në Greqi, se si ata demonstrojnë marrëdhënie normale apo të mira me shtetas grek. Një gjë duhet mbajtur mend, se çështja nuk vlerëson dhe tregon marrëdhënien e emigrantëve me institucionet greke, si autoritetet e emigracionit apo me policinë greke.




Së fundi ka një çështje e cila është e qartë, një kujtim i thjeshtë i marrëdhënieve të ngushta midis dy popujve dhe një kujtesë për rëndësinë që ka kjo marrëdhënie për palën shqiptare. Pothuajse gjysma e të anketuarve të këtij sondazhi tregojnë se të paktën një nga pjesëtarët e familjes të tyre jeton në Greqi për momentin dhe 45 përqind e tyre përgjigjen po. Edhe pse ne duhet të qartësojmë se në këtë rast shqiptarët referohen për pjesën tjetër të familjeve të tyre (si kushërinjtë, xhaxhallarët dhe kështu me radhë) dhe rëndësinë e afërsisë të afërmeve që ndjen shoqëria shqiptare është mjaft e ngjashme me atë që ndien për familjen kryesore.




Karakteristikat e kampionit:


1200 u intervistuan për këtë pyetësor, me një ndarje të barabartë prej 50 përqind femrash dhe 50 përqind e të anketuarve meshkujsh.



Grupmoshat e ndryshme janë të përfaqësuara në këtë kampion, me shumicën e të intervistuarve që janë në kategorinë e të rinjve rreth 18 deri 24 vjeç. Më tej, 30 përqind e të anketuarve janë në mes 18 dhe 24 vjeç e ndjekur nga 22 për qind që i përkasin moshës 25-34 vjeç. 18 përqind janë në mes 35-44 vjeç, ndërsa 15 për qind janë në mes 45 dhe 54 vjeç. 14 përqind i mbetur e mostrës është i përbërë nga njerëz mbi 55 vjeç.



Përsa i përket arsimimit, 46 përqind e kampionit është i përbërë nga njerëz të arsimuar deri në shkollën e mesme, ndërsa 18 përqind janë të diplomuar universitar. 3 përqind janë në proces apo kanë përfunduar studimet pasuniversitare, ndërsa 32 përqind kanë përfunduar ose janë në nivelin e parë të arsimit të mesëm (4 vjet) ose ciklin e parë të arsimit fillor (8-9 vjet).



Duke marrë parasysh situatën e punësimit të të intervistuarve tanë, 40 përqind e tyre raportojnë se janë të punësuar, ndërsa 15 përqind janë të papunë. 8 përqind e kampionimit është bërë prej pensionistëve, ndërsa 21 përqind prej studentësh e nxënësish. 17 përqind e të anketuarve janë të vetëpunësuar, duke përfshirë në këtë kategori edhe amvisat.

